



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

AUTORITETI I KONKURENCËS

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni që konsiston në përfitim e kontrollit të shoqërisë Fazua GmbH nga shoqëria Porsche Investments GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e investimit”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Porsche Investments GmbH, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, me objekt aktiviteti: blerjen dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, si dhe mbajtjen, menaxhimin dhe shitjen e këtyre pjesëmarrjeve.

Porsche Investments GmbH është një filial i shoqërisë Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me legjislacionin gjerman, një filial që zotërohet tërësisht dhe kontrollohet në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, e cila është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala shitëse: Shitësit janë 8 persona fizikë, shtetas të huaj dhe 8 shoqëri të huaja, të regjistruara në shtetin gjerman dhe aksionarë të shoqërisë target Fazua GmbH.

Shoqëria Target: Fazua GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e koncepteve dhe sistemeve të drejtimit të automjeteve në industrinë e biçikletave dhe komponentëve të tyre individualë, si dhe biçikletave të plota.

Shoqëria target nuk ka filiale dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.